

# Fletushkë informative për vizitorë

## Orari i vizitave

	Hëne	Martë	Mërkurë	Enjte	Premte	Shtunë	Diele *
<b>Vizita të rregullta</b> Grupi 1	nuk ka	13:00 - 17:00	13:00 - 17:00	13:00- 17:00	nuk ka	nuk ka	08:45 - 12:45
Grupi 2		17:00 - 21:00	17:00 - 21:00	17:00 - 21:00			12:45 - 16:45
<b>Vizita të veçanta</b> Grupi 1	nuk ka	13:00 - 17:00	13:00 - 17:00	13:00 - 17:00	nuk ka	nuk ka	08:45 - 12:45
Grupi 2		17:00 - 21:00	17:00 -21:00	17:00 - 21:00			12:45 - 16:45
<b>Kujdestarët, Avokatët, Organet.</b>	09.00 -14.30	09:00 - 20:00	09:00 - 20:00	09:00 - 20:00	09.00 -14.30	nuk ka	10.00 - 14:45
<b>Vizitë kohë gjatë</b> Grupi 1	08:00 -12:00	08:00 - 12:00	08:00 - 12:00	08:00 - 12:00	08:00 -12:00	nuk ka	11:00 - 15:00
Grupi 2	nuk ka	15:00 - 19:00	15:00 - 19:00	15:00 - 19:00	nuk ka	nuk ka	nuk ka

\* të dielave dhe ditëve të lira zyrtare, nëse ato bien në një të martë, mërkurë apo të enjte.

Hyrja është gjithmonë 15 minuta para fillimit të vizitës apo më së voni 30 minuta pas terminit të vizitës.

Të burgosurit mund të pranojnë vizita dy herë në muaj. Nëse ka terminë të lira, atëherë mund të lejohen edhe dy vizita tjera si vizita të veçanta.

Të burgosurit me të drejtë pushimi nuk kanë të drejtë pranimit të vizitave të veçanta apo kohë gjata.

Secili i burgosur guxon të pranon më së shumti tre persona të rritura për një vizitë. Numri i fëmijëve nuk është i kufizuar. Vizitorët e moshës madhore do të regjistrohen me emër të plotë personal.

Përcaktimi i terminit bëhet nga i burgosuri apo vizituesi. Nga ana e vizituesit kjo mund të bëhet vetëm me telefon nën numrin – **02191/ 595467** – Hëne deri Premte prej orës **12.00 – 14.00** apo me E-Mail ( **[besuchskoordination@jva-remscheid.nrw.de](mailto:besuchskoordination@jva-remscheid.nrw.de)** ).

Dhënia e terminit bëhet maksimalisht 8 javë më parë, për më së shumti 2 vizita.

Dhënia e terminëve të veçanta (vizita e 3. dhe 4.) për vizitën e 3. është e mundur vetëm për javën e tretë të secilit muaj dhe për vizitën e 4. vetëm për javën e 4. të muajit të njëjtë .

Vizitorët të burgosurve me rast të vizitës (deri katër herë në muaj) guxojnë të ju dhurojnë mjete ushqimore apo kënaqësie vetëm nga automatet (artikuj duhani, ëmbëlsira) dhe këto të ndërmjetësuara nga ana e institucionit. Për këtë e lejuar është vetëm **njëra** nga tre mundësitë e mëposhtme:

- 1.) 2 Copë artikuj duhani (tek qesja e duhanit lejohet edhe një pako letre cigaresh)
- 2.) 1 Copë artikull duhani dhe 7 copë mjete ushqimore
- 3.) 14 Copë mjete ushqimore

Bartja e parave të gatshme në zonën e vizitës për një palë vizite është e kufizuar në 25 €

Shfrytëzimi i automateve të vendosura është i lejuar **vetëm për vizitorë para fillimit të vizitës.**

Para çdo vizite secili vizitorë së pari do kontrollohet. Kontrollimi do bëhet përmes detektorit manual dhe kontrollit fizik të trupit. Gjësendet e sjella me vete duhet të mbyllen në kasafortë.

Pas kryerjes së kontrollimit shfrytëzimi i tualetit është i mundur vetëm në zonën e hyrjes para zonës së kontrollimit, gjë që do çon deri tek kontrollimi i serishëm.